

VENDIM
Nr. 51, datë 6.7.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 40, DATË 23.9.2016, “PËR LICENCIMIN
E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME LUSHNJË”**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”; të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe të rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 40, datë 23.9.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë”.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë ka aplikuar me anë të shkresës nr. 706 prot., datë 27.6.2018, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor.

- Aplikimi i shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit, mbi ndryshimin e drejtuesit ligjor, konkretisht:

- dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- drejtuesi ligjor plotëson kriteret e parashikuara në rregulloren e licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 40, datë 23.9.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë”, bëhet ky ndryshim:

“Drejtues ligjor: Erjet Dhima”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani